



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.

Gramsh më ____ / ____ /2024

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

10.09.2024

Drejtuar: OE "ARENA MK" sh.p.k me adresë : Fier Ballsh DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndertesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14. 9333

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur ,e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit VI: REF-17122-08-27-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mbikqyrja e punimeve për objektin "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh" , me afat 5 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike :Nr.56, datë 2.09.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE "" INDAY - 18 " " sh.p.k & REAN 95 L87312201H & J61827043V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 800 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind) lekë , PA TVSH

2. "ARENA MK" sh.p.k

L67619801Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

3. "G B Civil Engineering" sh.p.k

L51825011V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

4. BOE"GRAMA" sh.p.k & "ZENIT&CO" sh.p.k

J77304712J & K61731002D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 387 447.53 (një milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e katër pikë pesëdhjetë e tre)lekë , PA TVSH

5. BOE “ HTS COMPANY” sh.p.k & “MAGNA CHARTA” sh.p.k M11619018P& L92318021H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

6. “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k

M11417503F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

7. “INSTITUTI DEKLIADA –ALB ” sh.p.k

K71606006A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

8. “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" ” sh.p.k

K71828007J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 382 842.1(një milion treqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e dy pikë një) lekë , PA TVSH

9. “NET-GROUP” sh.p.k

L72023002P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 801.05 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e një pikë zero pesë)lekë , PA TVSH

10. “NOVATECH STUDIO” sh.p.k

L01717030C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë , PA TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" ” sh.p.k

K71828007J

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

“INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" sh.p.k, Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.1 është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

OE “INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM” shpk ka depozituar në sistem shërbime të

mëparshme si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi me objekt “Supervizim Rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm, njësia administrative Cukalat, bashkia Ura Vajgurore” e lidhur ndërmjet bashkisë Ura Vajgurore dhe OE “INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM” shpk.
- Kontratë Shërbimi me objekt “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Salari – Nivicë, bashkia Tepelenë” e lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE “IMES- D” shpk & “INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM” shpk.

Duke pare objektet e kontratave rezulton se asnjë nga shërbimet që OE “INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM” shpk ka depozituar në sistem nuk janë të ngjashme me shërbimin objekt prokurimi.

Për sa më sipër duke qënë se ky OE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit skualifikohet nga procedura

2. BOE “HTS COMPANY” sh.p.k & “MAGNA CHARTA” sh.p.k M11619018P& L92318021H

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

BOE-“HTS COMPANY” sh.p.k & “MAGNA CHARTA” sh.p.k, Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

4.Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Ing. Ndërtimi
- 1 (një) Ing. Hidroteknik
- 1 (një) Ing. Topograf/Gjeodet/Markshajder

5.Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar për:

-1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

-Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profilin e punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.

Si OE “HTS COMPANY” shpk ashtu edhe OE “MAGNA CHARTA” shpk të formulari

përmbledhës i vetëdeklarimit, Deklarata B, nuk kanë deklaruar emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka leshuar këto dokumente.

Për sa më sipër duke qënë se ky BOE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit skualifikohet nga procedura

3. BOE“GRAMA” sh.p.k & “ZENIT&CO” sh.p.k

J77304712J & K61731002D

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

BOE- “GRAMA” sh.p.k & “ZENIT&CO” sh.p.k, Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.1 është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularvlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

OE “GRAMA” shpk ka dorëzuar disa shërbime të ngjashme në sistemin elektronik por asnjëra prej tyre nuk plotëson kërkesat e kërkuara nga AK sipas kriterëve të vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.1.

Njëra nga këto është në gjuhë të huaj dhe nuk meret parasysh pasi dokumentet duhet të jenë të shkruara ose të përkthyer në gjuhën shqipe,

Te një shërbim tjetër i ngjashëm ku është firmosur kontratë me objekt “Mbikqyrje e punimeve për objektin “Mbrotjtje lumore në lumin Erzen, Ibë e Poshtme” midis Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës dhe BOE “GRAMA” shpk & “AMCO ENGINEERING” shpk mungon kontrata e bashkimit të operatoreve dhe prokura e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

Dhe për një tjetër shërbim ka futur në sistem vetëm fatura tatimore duke mos plotësuar kërkesat e AK pasi nuk ka paraqitur as kontratën e mbikqyrjes, as formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

Ndërsa OE “ZENIT & CO” shpk ka depozituar në sistem shërbime të mëparshme si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi me objekt “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për objektin “Ndërtim, asfaltim, rrjeti inxhinerik I rrugës Nr 1, Lëkurës, Sarandë, Loti 1+2” e lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE “Derbi-E” shpk & “ZENIT & CO” shpk.
- Kontratë Shërbimi me objekt “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për objektin “Rehabilitimi i lagjeve 4, 5 dhe 6 në bashkinë Kukës” e lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE “Derbi-E” shpk & “ZENIT & CO” shpk.
- Kontratë Shërbimi me objekt “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për objektin “Ndërtimi i rrugës Rrëshen – Sheshaj, Mirditë” e lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE “Derbi-E” shpk & “ZENIT & CO” shpk.
- Kontratë Shërbimi me objekt “Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës Sami Frashëri” e lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe OE “ZENIT & CO” shpk.
- Kontratë Shërbimi me objekt “Supervizion punimesh Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1 ” e lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE “ZENIT & CO” shpk. Duke pare objektet e kontratave rezulton se asnjë nga shërbimet që OE “ZENIT & CO” shpk ka depozituar në sistem nuk janë të ngjashme me shërbimin objekt prokurimi. Për sa më sipër duke qënë se ky BOE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit skualifikohet nga procedura

4. “NOVATECH STUDIO” sh.p.k

L01717030C

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

“NOVATECH STUDIO”sh.p.k, Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.5 është kërkuar:

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar për:
 -Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, OE “NOVATECH STUDIO”sh.p.k ka deklaruar z.K. Zh. si personin specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin. Nga verifikimi i deklaratave i “Listëpagesave e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Qershor e Korrik të dorëzuar në sistemin elektronik nga OE “NOVATECH STUDIO”sh.p.k rezulton se z.K. Zh. nuk figuron në këto listëpagesa.

Për sa më sipër duke qënë se ky OE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit nga procedura.

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

BOE- "Inday-18" sh.p.k "REAN 95" sh.p.k , Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.5 është kërkuar: Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:-1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

-Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin. Për sa më sipër te formulari përmbledhës i vetëdeklarimit vetëm OE "REAN 95" ka deklaruar si pjesë të stafit të tij 1 punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" dhe 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

OE "INDAY – 18" nuk ka deklaruar te formulari përmbledhës i vetëdeklarimit si pjesë të stafit të tij asnjë punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" dhe asnjë specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin. Duke qënë se jemi në rastet e BOE dhe secili nga OE duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" dhe 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, atëherë jemi në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit pikërisht të pikes 2.3.5. Nga AK është kërkuar nga OE (BOE) që në kriteret e veçanta të kualifikimit përkatësisht për stafin e kërkuar sipas pikës 2.4 dhe 2.5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punes, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.Asnjë nga OE nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, sipas kërkesave të AK. Në kriteret e vecanta të kualifikimit për Lotin VI në pikën 2.3.1 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të paraqes\ë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës. a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularvlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

OE "INDAY - 18" shpk nuk ka dorëzuar asnjë punë të ngjashme me objektin e prokurimit. Për sa më sipër duke qënë se ky BOE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit skualifikohet nga procedura

6. "INSTITUTI DEKLIADA –ALB" sh.p.k

K71606006A

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

INSTITUTI DEKLIADA – ALB" sh.p.k, Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:

-1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

OE "INSTITUTI DEKLIADA-ALB" shpk të formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, Deklarata B, nuk ka deklaruar një punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" duke mos plotësuar kërkesat e AK.

"INSTITUTI DEKLIADA – ALB" sh.p.k nuk ka dorëzuar në SPE Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme), Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme), Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme). Për sa më sipër duke qënë se ky OE nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit skualifikohet nga procedura .

Në lidhje me ofertat me të njëjtën vlerë komisioni vlerësimi të ofertave zhvilloi procedurën e shortit më datë 25.09.2024 dhe u kualifikuan operatorët ekonomik si më poshtë:

1. "ARENA MK" sh.p.k
2. "G B Civil Engineering" sh.p.k
3. "HYDRO-ENG CONSULTING" sh.p.k

Duke iu referuar procedurës së lart përmendur, njoftojmë OE "ARENA MK" sh.p.k me adresë : Fier Ballsh DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Nderresa private Nr.2, Zona kadastrale 1566,

Nr.pasurie 93/14. 9333 “ se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë ,pa tvsh /totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh me adresë bulevardi “10 korriku”* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10(dhejtë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 1 327 338 (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë, *PA TVSH* , siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

**ZYRTARI I AUTORIZUAR
N/KRYETARI I BASHKISË**

Tajar BICI